



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

**PLANI STRATEGJIK
2011-2013**

Tetor 2010

Përmbajtja

1.	Hyrje	3
2.	Konteksti për zhvillimin e strategjisë 2011-2013.....	4
3.	Vizioni, misioni dhe vlerat e KShH-së	7
3.1	Vizioni	7
3.2	Misioni	8
3.3	Vlerat e KShH-së.....	8
4.	Drejtimet strategjike të KShH-së për vitet 2011-2013	9
4.1	Zhvillimi i reformave ligjore dhe institucionale	10
4.2	Zhvillimi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme	11
4.3	Përmirësimi i veprimtarisë së organeve të pushtetit gjyqësor për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm	13
4.4	Përmirësimi i zbatimit të të drejtave dhe trajtimit të personave të dënuar me heqje lirie... 15	
4.5	Akresi i qytetarit në strukturat publike vendore	Error! Bookmark not defined.
4.6	Akresi i qytetarit në strukturat publike vendore.....	17
5.	Zhvillimi institucional i KShH-së	Error! Bookmark not defined.
5.1	Përmirësimi i menaxhimit dhe kualifikimi i burimeve njerëzore Error! Bookmark not defined.	
5.2	Përmirësimi i procesit të vëzhgimit	Error! Bookmark not defined.
5.3	Rritja e qëndrueshmërisë financiare të organizatës.....	Error! Bookmark not defined.
5.4	Lobimi dhe fuqizimi i rrjetëzimit	Error! Bookmark not defined.
5.5	Promovimi i punës dhe i vlerave të organizatës.....	Error! Bookmark not defined.

Shkurtime

KShH – Komiteti Shqiptar i Helsinkit

OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara

OSBE – Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Europë

ODIHR – Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

BE – Bashkimi European

KQZ – Komisioni Qendror Zgjedhor

NJPT - Njësia për Parandalimin e Torturës

KEDNJ – Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut

MSA – Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit

1. Hyrje

Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka kënaqësinë t'ju prezantojë planin strategjik për vitet 2011-2013.

Ky dokument paraqet në mënyrë të përmbledhur fushat e veprimit të KShH-së për tri vitet në vijim, nëpërmjet të cilave organizata synon të kontribuojë në përmbushjen e misionit të saj.

Ky dokument është rezultat i punës intensive, i analizave, diskutimeve të stafit, asamblesë dhe bordit të KShH-së, si dhe i konsultimeve me partnerë dhe përfitues të drejtpërdrejtë.

KShH-ja është organizata e parë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri, e themeluar në vitin 1990 nga një grup intelektualësh shqiptarë, nën emrin *Forumi për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut*. Më 22 mars 1992 organizata mori emrin *Komiteti Shqiptar i Helsinkit*. Misioni i kësaj organizate që nga themelimi e në vazhdim ka qenë mbrojtja e lirive dhe e të drejtave të njeriut. Në sajë të punës objektive dhe cilësore, ekspertizës dhe përkushtimit në përmbushjen e misionit të vet, KShH-ja gëzon reputacion mjaft pozitiv në publikun shqiptar dhe më gjerë.

Organizata ka zyrën e saj në Tiranë, por ajo zhvillon aktivitetin e vet në të gjithë Shqipërinë, e ndihmuar nga rrjeti i korrespondentëve të saj në Kukës, Gjirokastër, Fier, Vlorë, Korçë, Elbasan dhe Shkodër. Korrespondentët në rrethe, jo vetëm sigurojnë ekspertizë dhe informacion për çështje të mprehta në lokalitetet përkatëse, por edhe monitorojnë respektimin e të drejtave të qytetarëve nga pushteti lokal.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit mban statusin e një organizate jofitimprurëse, në formën e shoqatës. Organi vendimmarrës i KShH-së është asambleja e përgjithshme e cila përzgjedh pesë nga anëtarët e saj për të formuar bordin këshillimor. Asambleja zgjedh, gjithashtu, drejtorin ekzekutiv që është përgjegjës për drejtimin e organizatës dhe vënien në zbatim të strategjisë së saj, të programeve dhe të projekteve që lidhen me të.

Gjatë viteve 2011-2013 kjo organizatë do të vazhdojë aktivitetin e vet në përmbushjen e misionit dhe vlerave të saj për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri, sipas Kushtetutës, Aktit Final të Helsinkit dhe dokumenteve të tij pasuese, detyrimeve ligjore ndërkombëtare të ndërmarra në Këshillin e Europës dhe Kombet e Bashkuara, si dhe në përputhje me normat e të drejtave të njeriut, promovuar nga Bashkimi Europian.

KShH-ja do të vazhdojë të kontribuojë për fuqizimin e legjislationit dhe zbatimin rigoroz të tij; do të promovojë barazinë e njerëzve përpara ligjit, në mënyrë që të minimizohen të gjitha format e diskriminimit, si dhe do të nxitë rritjen e përgjegjshmërisë së administratës publike në zbatimin me korrektësi të ligjit, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të kësaj administrate.

Gjatë tri viteve në vazhdim KShH-ja do t'i kushtojë rëndësi të veçantë forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve të tij njerëzore dhe institucionale.

2. Konteksti për zhvillimin e strategjisë 2011-2013

Pavarësisht zhvillimeve pozitive, vendi ynë, në përpjekjet e veta për ndërtimin e demokracisë, vazhdon të përballet me një sërë sfidash që kanë të bëjnë me respektimin e të drejtave të njeriut sipas standardeve ndërkombëtare, zbatimin e ligjit dhe fuqizimin e shtetit ligjor, si dhe zhvillimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme.

Gjatë viteve të fundit shteti shqiptar është përfshirë në një sërë iniciativash dhe reformash në sektorë të ndryshëm. Nënshkrimi i marrëveshjes së stabilizim-asociimit në vitin 2006 çeli një etapë të re për Shqipërinë në ndërmarrjen e reformave me qëllim përshtatjen e legjislationit vendës me atë të Bashkimit Europian. Ndërmarrja e reformave legjislative përbën një proces mjaft delikat, i cili kërkon monitorim nga afër të vetë procesit dhe propozimeve, në mënyrë që të garantohet respektimi i standardeve ndërkombëtare të të drejtave të qytetarëve shqiptarë.

Sistemi i drejtësisë është duke u përballur me ndryshime që i përkasin kuadrit ligjor, infrastrukturës dhe burimeve njerëzore. Pavarësisht zhvillimeve pozitive në disa fusha, ende ka nevojë për përmirësime të mëtejshme në sistemin gjyqësor.

Vonesat dhe zvarritjet në procedurat gjyqësore, korrupsioni në sistemin e drejtësisë, si dhe dështimi, në disa raste, në ekzekutimin e vendimeve të gjykatave vazhdojnë të mbeten ende probleme shqetësuese. Gjithashtu, drejtësia për të miturit vazhdon të përballlet me një numër të madh problemesh. Shërbimet ligjore, sidomos ndihma ligjore falas që duhet ofruar nga shteti, nuk ka nisur ende të aplikohet, ndërkohë që shërbimet ligjore ofruar nga shoqëria civile nuk financohen tërësisht nga buxheti i shtetit, por mbeten kryesisht të varura nga donacionet e huaja. Në këto kushte, rritja e transparencës në gjyqësor dhe aksesit i qytetarëve në shërbimet ligjore mbeten një kërkesë ende e paplotësuar.

Vihet re, gjithashtu, që shtetasit shqiptarë nuk e njohin sa duhet KEDNJ-në dhe procedurat përkatëse të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut duke humbur kështu mundësinë për t'iu drejtuar kësaj gjykate në rastet e shkeljes së të drejtave të tyre nga ana e shtetit shqiptar. Probleme të tjera janë: dështimi në disa raste në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, duke cenuar të drejtën për zhvillimin e një procesi ligjor; kultura e varfër ligjore e qytetarëve, sidomos e atyre që u përkasin grupeve të shpërfillura. Shpesh këta qytetarë nuk kanë asnjë lloj informacioni në lidhje me mekanizmat për mbrojtjen dhe adresimin e të drejtave të tyre nga strukturat përkatëse shtetërore.

Në 28 qershor 2009 Shqipëria mbajti zgjedhjet e saj parlamentare, të cilat, siç u cituan nga Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, shënuan një progres krahasuar me zgjedhjet e mëparshme. Në këto zgjedhje, hapa pozitivë janë vërejtur në interesimin e qytetarëve për të zbatuar të drejtën e tyre për të zgjedhur, si dhe në mundësitë reale që u ofrohen për këtë qëllim nga legjislacioni dhe administrata zgjedhore. Zgjedhjet e vitit 2009 përmbushën pjesën më të madhe të kriterëve, por, gjithsesi, nuk mundën të përmbushnin tërësisht standardet për zgjedhje demokratike. Reforma zgjedhore u ndërmor nga dy partitë e mëdha duke u kundërshtuar fuqimisht nga një pjesë e partive të vogla. Kundërshtime pati edhe për rezultatin e zgjedhjeve, kundërshti të cilat u përshkallëzuan deri në protesta qytetare dhe që nuk kanë gjetur ende zgjidhje. Mediat dukej se mbështetnin hapur dy partitë e mëdha në vend, pa treguar shumë interes për partitë më të vogla. Në kushtet kur zgjedhjet e drejta e të lira përbëjnë një nga parimet bazë të funksionimit të shoqërisë demokratike, është e domosdoshme që subjektet e specializuara për të drejtën e zgjedhjes dhe për procesin zgjedhor të vazhdojnë të kontribuojnë për përmirësimin e mëtejshëm të

infrastrukturës ligjore, institucionale, të materialeve të zgjedhjeve, si edhe për monitorimin e proceseve zgjedhore.

Një nga fushat e veprimtarisë së KShH-së prej vitesh ka qenë respektimi i të drejtave të personave të dënuar me heqje lirie, me fokus të veçantë për grupet e cenushme. Fokusi i vëzhgimit ka qenë respektimi i të drejtave të tyre në përputhje me standardet ndërkombëtare, legjislacionin shqiptar dhe rekomandimet e mekanizmave ndërkombëtarë për monitorimin e mjediseve të paraburgimit dhe burgjeve. Reforma ligjore në sistemin penitenciar dhe infrastruktura ka shënuar progres. Gjatë viteve 2009 – 2010 ka pasur ndryshime me krijimin dhe funksionimin e shërbimit të provës dhe rregullimeve ligjore dhe nënligjore në fushën penitenciare. Pavarësisht sa më sipër, funksionimi i Komisionit Mbikëqyrës të Ekzekutimit të Vendimeve me Burgim vazhdon të jetë joeficient dhe personat e burgosur dhe të paraburgosur nuk kanë dijeni për të. Me gjithë zhvillimet pozitive të përmendura më lart, vazhdojnë të vihen re problematika në lidhje me respektimin e të drejtave dhe keqtrajtimin e personave të dënuar me heqje lirie.

Megjithëse janë miratuar strategji dhe programe zhvillimi në disa sektorë, ende vihet re një mungesë efience nga ana e institucioneve shtetërore përgjegjëse për ndërmarrjen e masave të nevojshme me qëllim arritjen e objektivave të vendosur, sidomos në nivelin vendor, në mënyrë të veçantë për minoritetin rom, komunitetin egjiptian, grupet e cenushme, si: gratë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, LGBT¹ etj. Këto komunitete bëhen pre e mosrespektimit të të drejtave të njeriut.

Infrastruktura e shkatërruar në lagjet e komuniteteve romë dhe egjiptiane, mungesa e shërbimeve sociale për familjet e tyre, mungesa e të ardhurave për të paguar taksat, mungesa e ndihmës sociale nga ana e shtetit, kushtet e vështira dhe mosarsimimi janë disa probleme që shqetësojnë këto komunitete në Shqipëri. Shpesh përfaqësues të këtyre komuniteteve shprehen se ndiejnë forma të fshehura diskriminimi dhe përjashtimi social.

Me gjithë punën e deritanishme nga KShH-ja dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile, ende mbetet shumë për t'u bërë për konsolidimin e demokracisë në Shqipëri.

¹ LGBT – persona të dy gjinive me orientim homoseksual, biseksual dhe hermafroditët.

3. Vizioni, misioni dhe vlerat e KShH-së

3.1 Vizioni

KShH-ja beson në një shoqëri shqiptare ku qytetarët të ushtrojnë lirisht të drejtat dhe liritë e tyre themelore në të gjitha aspektet e jetës. Me gjithë përmirësimet e viteve të fundit, administrata publike në Shqipëri vazhdon të ketë mangësi në nivelin e kapaciteteve të saj dhe profesionalizmin në ofrimin e shërbimeve. Për të nxitur garantimin e standardeve për shërbimet që u ofrohen qytetarëve shqiptarë, llogaridhënien ndaj qytetarëve si dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të administratës publike, shoqëria shqiptare ka nevojë për funksionimin e strukturave të pavarura të cilat duhet të jenë të afta të monitorojnë në mënyrë të paanshme dhe eficiente, dhe të kenë guximin të reagojnë dhe të ofrojnë alternativa për respektimin më të mirë të të drejtave të njeriut dhe zbatimin korrekt të legjislacionit.

Organizatat e shoqërisë civile mund të luajnë rol të rëndësishëm në përmirësimin e mjedisit për respektimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri, si dhe vetë respektimin e këtyre të drejtave, si:

- avokatë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve;
- monitorues të zbatimit të detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare nga qeveria e Shqipërisë;
- partnerë në dialogun me autoritetet për mënyrën e forcimit të efektshëm të respektimit të të drejtave të njeriut;
- organizata eksperte që ofrojnë dije, pikëpamje të thelluara dhe ekspertizë për një llojshmëri grupesh të interesuara, për mënyrën e përmirësimit të respektimit të të drejtave të njeriut.

KShH-ja do të vazhdojë të luajë rol të rëndësishëm në mbrojtjen, promovimin dhe ndërgjegjësimin e shtetasve shqiptarë për të drejtat dhe liritë themelore të tyre.

3.2 Misioni

Misioni i KShH-së është të kontribuojë për respektimin e të drejtave të njeriut, forcimin e shtetit ligjor, si dhe zhvillimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme, në përputhje me Kushtetutën, aktet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Mandati i KShH-së në kuadër të përmbushjes së misionit është:

- Të monitorojë, të llojojë dhe të mbrojë ligjërisht, në mënyrë proaktive së bashku me aktorë të tjerë të shoqërisë civile, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, për përmbushjen e standardeve për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.
- Të sensibilizojë qytetarët shqiptarë dhe të gjithë aktorët përkatës për të drejtat dhe liritë e tyre.
- Të ndihmojë në zbatimin e ligjeve nëpërmjet ndërtimit të kapaciteteve të administratës publike.
- Të nxitë llogaridhënien e administratës publike në zbatimin korrekt të ligjeve nëpërmjet denoncimit publik të shkeljeve të kryera.
- Të përgatitë raporte alternative për zbatimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri.
- Të ofrojë oponencë ligjore dhe ekspertizë për përmirësimin e legjislacionit dhe harmonizimin e tij me *acquis communautaire* si dhe zbatimin e tij në praktikë, duke rivendosur të drejtat e shkelura.

3.3 Vlerat e KShH-së

KShH-ja është një organizatë e cila udhëhiqet nga misioni dhe një sërë vlerash dhe parimesh, të cilat i përfshin dhe i respekton në çdo aspekt të punës së vet.

Është një organizatë me profil të qartë dhe të spikatur në shoqërinë civile shqiptare, e mirënjohur për punën e vet në respektimin e parimeve demokratike, në qëndrimin etik, parimor dhe të paanshëm politikisht për promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Është një organizatë e cila vepron me paanshmëri, objektivitet, integritet, profesionalizëm, pasion, përkushtim dhe transparencë në qëndrimet e veta për çështjet e të drejtave dhe lirive të njeriut, demokratizimit dhe forcimit të shtetit ligjor.

KShH-ja vlerëson bashkëpunimin aktiv me organizata analoge kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim përmbushjen e misionit të vet.

4. Drejtimit strategjike të KShH-së për vitet 2011-2013

Nga procesi i analizave, diskutimeve dhe konsultimeve të kryera në kuadër të përgatitjes së strategjisë së KShH-së për periudhën 2011-2013, u nxor si përfundim se, me gjithë përpjekjet e kryera nga shoqëria civile, si dhe institucionet dhe organizmat ndërkombëtarë, çështjet e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut vazhdojnë të mbeten shqetësim i konsiderueshëm për vendosjen e demokracisë funksionale në Shqipëri.

Edhe gjatë tre vjetëve në vijim, KShH-ja do të vazhdojë të kontribuojë në:

- zhvillimin e reformave institucionale dhe ligjore që synojnë forcimin e shtetit ligjor dhe përmirësimin e respektimit të të drejtave të njeriut;
- zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme;
- përmirësimin e veprimtarisë së organeve të pushtetit gjyqësor, për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si dhe rritjen e aksesit të qytetarëve në këto organe;
- respektimin e të drejtave dhe trajtimin human të personave me liri të kufizuar nga administrata e Policisë së Shtetit dhe administrata e burgjeve;
- respektimin e zbatimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, me fokus të veçantë në grupet e cënueshme.

KShH-ja do të vazhdojë të promovojë respektimin e të drejtave të njeriut të përcaktuara në KEDNJ, si: e drejta për liri dhe siguri; e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare; liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fese; liria e shprehjes dhe ndalimi i diskriminimit.

Për të kontribuar në mënyrë efektive dhe për të rritur impaktin e veprimtarisë së vet, KShH-ja do të vazhdojë të përdorë metoda pune gjithëpërfshirëse dhe të integruara dhe do të jetë proaktiv dhe reagues në ndërmarrjen e veprimeve. Ky aktivitet do të vazhdojë të fokusohet në: kryerjen e monitorimeve, raportimet për shkeljet e të drejtave të njeriut, përgatitjen e raporteve alternative, denoncimin publik nëpërmjet konferencave të shtypit dhe deklaratave për shtyp, lobimin dhe mbrojtjen ligjore, ofrimin e trajnimeve dhe seminareve, takimet e ekspertëve për çështje tematike, ndihmën ligjore falas për viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut, oponencën ligjore dhe ekspertizën për reformat ligjore e institucionale dhe përparimin e Shqipërisë drejt familjes europiane, si dhe veprimtaritë sensibilizuese. Për sa më sipër, KShH-ja do të bashkëpunojë me median e shkruar dhe atë elektronike.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit synon të vendosë dhe të forcojë bashkëpunime të frytshme me organizata të tjera kombëtare e ndërkombëtare, aktive në fushën e të drejtave të njeriut, si dhe të përfshihet në rrjetëzime me organizata që kanë mision dhe vizion të përafërt me të.

4.1 Zhvillimi i reformave ligjore dhe institucionale

Dhënia e kontributit të KShH-së për zhvillimin e reformave që synojnë forcimin e shtetit ligjor dhe përmirësimin e respektimit të të drejtave të njeriut

Gjatë viteve të fundit qeveria shqiptare ka ndërmarrë një sërë nismash ligjore dhe institucionale për fuqizimin e shtetit ligjor dhe të drejtave të njeriut. Gjithashtu, në zbatim të marrëveshjes së stabilizim-asociimit me Bashkimin Europian, i është dhënë një shtysë e rëndësishme zhvillimit të demokracisë në Shqipëri. Për rëndësinë e madhe që ka, ky proces ka qenë dhe do të vazhdojë të mbetet nën fokusin dhe vëmendjen e KShH-së edhe gjatë tre vjetëve në vijim.

Në këtë kuadër, KShH-ja ka përcaktuar si përparësi monitorimin dhe oponencën ndaj reformave ligjore dhe institucionale në:

- Ofrimin e mendimit ligjor dhe lobimin për aktet e reja normative dhe ndryshimet në ligjet ekzistuese, me fokus sanksionimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

- Monitorimin e kuadrit ligjor për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut mbi bazën e standardeve të parashikuara në Kushtetutë dhe në aktet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.
- Reagimin me anë të letrave të hapura dhe deklaratave për shtyp për nevojën e përmirësimeve ligjore dhe institucionale.

4.2 Zhvillimi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme

Respektimi i së drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur është kërkesë thelbësore për vendosjen e demokracisë në vend. Edhe pse kuadri ligjor i garanton të drejtën individit për ta ushtruar këtë të drejtë, praktika e viteve të fundit ka nxjerrë në pah një sërë problemesh lidhur me moszbatimin e standardeve për zhvillimin e zgjedhjeve të ndershme dhe demokratike. Në këto kushte, KShH-ja e vlerëson mjaft të rëndësishme ndërhyrjen e vet për garantimin e mbajtjes së zgjedhjeve të lira dhe të ndershme në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe angazhimet e OSBE-së. Strategjitë e ndërhyrjes së KShH-së në këtë kuadër janë:

a) Rritja e ndërgjegjësimit publik dhe njohja e të drejtave të tyre politike

Nga vëzhgimet e kryera vihet re se qytetarët shqiptarë shpesh kanë njohuri të kufizuara për procedurat e votimit. Shpesh atyre u mungon informacioni i duhur në lidhje me afatet, mënyrat për të apeluar rastet e parregullsive me listat e votuesve, si dhe të gjitha dokumentet e kërkuara për procesin e votimit. Për rrjedhojë, ka raste kur qytetarët nuk arrijnë të ushtrojnë siç duhet të drejtën e tyre të votës. Në këto kushte, KShH-ja synon:

të kontribuojë për rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve shqiptarë për të drejtat e tyre politike;

të bashkëpunojë me organizata të tjera për të edukuar dhe për të sensibilizuar votuesit për të drejtat e tyre për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur;

të rritë ndërgjegjësimin publik nëpërmjet shpërndarjes së materialeve edukuese, fushatave sensibilizuese, publikimeve në faqen zyrtare të internetit të KShH-së, artikujve të shkruar dhe intervistave të dhëna në media, si dhe deklaratave publike;

të ndërgjegjësojë qytetarët shqiptarë për të shprehur vullnetin e tyre politik me votë;

t'i njohë ata me të drejtat dhe rolin e tyre për një proces zgjedhor demokratik.

KShH-ja do të vazhdojë të bëjë publik qëndrimin e vet në lidhje me ecurinë e procesit zgjedhor. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2009, KShH-ja reagoi nëpërmjet 13 deklaratave të përcjella shtypit të shkruar dhe atij elektronik. Një ditë pas procesit të votimit u zhvillua një konferencë me gazetarë të medias elektronike dhe asaj të shkruar, ku u prezantua raporti paraprak për zgjedhjet. Konferenca u transmetua në 10 media elektronike dhe në 7 media të shkruara.

b) Kontribuimi për përmirësimin e kuadrit ligjor zgjedhor

Në kuadër të zhvillimit të zgjedhjeve të vitit 2009, Kodi zgjedhor u ndryshua nga dy partitë më të mëdha politike në vend. Ndryshimi i Kodit zgjedhor shkaktoi reagime të forta nga partitë e vogla, të cilat edhe më vonë gjatë zgjedhjeve deklaruan se ky Kod zgjedhor favorizon më shumë partitë e mëdha në kurriz të votave të tyre. Si rrjedhojë, ndihet nevoja e rishikimit sërish të Kodit zgjedhor. Në këtë proces, KShH-ja do të luajë rol aktiv nëpërmjet dhënies së kontributit të vet për reformën ligjore zgjedhore, në bashkëpunim me aktorë të tjerë të shoqërisë civile në Shqipëri. Së bashku me organizata të tjera aktive në këtë fushë, do të llojë me qëllim që të sigurohet një përqasje përfshirëse në këtë proces shumë të rëndësishëm. Për më tepër, do të jetë aktive në ofrimin e opinionëve dhe sugjerimeve të veta për një shqyrtim të efektshëm të Kodit zgjedhor në Shqipëri, si një parakusht për procese zgjedhore të lira, të ndershme dhe demokratike. KShH-ja do të përdorë më mirë letrat e hapura, sesionet dëgjimore në komisionet parlamentare, takimet me deputetë dhe median për të pasur ndikim më efektiv.

c) Monitorimi i ushtrimit të të drejtave politike gjatë zgjedhjeve

KShH-ja është një organizatë mjaft aktive në monitorimin e procesit zgjedhor në Shqipëri, kontributi i së cilës është njohur dhe është vlerësuar jo vetëm brenda Shqipërisë, por edhe nga organizma ndërkombëtarë. Në zgjedhjet e 29 qershorit 2009, KShH-ja përzgjodhi 150 vëzhgues, të cilët, pasi u trajnuan, monitoruan rreth 800 qendra votimi gjatë procesit parazgjedhor dhe rreth 700 qendra votimi gjatë procesit të votimit dhe numërimit në qytetet: Tiranë, Durrës, Shkodër,

Elbasan, Gjirokastrë, Kukës, Fier, Vlorë dhe Korçë. Gjatë procesit të numërimit u monitoruan 25 qendra të numërimit të votave.

KShH-ja e realizon procesin e monitorimit të zgjedhjeve në bashkëpunim me rrjetin e vëzhguesve vendorë. Roli i KShH-së në monitorimin e zgjedhjeve fokusohet në: monitorimin e procesit zgjedhor që nga ngritja dhe funksionimi i administratës zgjedhore, shpalljen e listave paraprake dhe përfundimtare të zgjedhësve, informimin e qytetarëve për listat, procesin e votimit dhe numërimit të votave, raportimin për situatën, si dhe paraqitjen dhe bërjen publike të përfundimeve dhe rekomandimeve për monitorimet e kryera. Gjetjet mbi zhvillimin e reformës zgjedhore, KShH-ja i përfshin në raportet e ndërmjetme dhe në raportin përfundimtar ku përfshihen rekomandimet përkatëse për përmirësimin e sistemit legjislativ dhe të procesit zgjedhor në tërësi.

KShH-ja do të monitorojë nga afër veprimtarinë dhe aktet e nxjerra nga KOZ-ja, do të ndjekë të gjithë hapat që do të ndërmerren në kuadrin e reformës zgjedhore për të cilat do të ofrojë rekomandime konkrete dhe ekspertizë, si dhe do t'u përcjellë organeve përkatëse, nëpërmjet letrave të hapura dhe deklaratave publike, problemet e vërejtura së bashku me sugjerimet dhe rekomandimet për përmirësim.

4.3 Përmirësimi i veprimtarisë së organeve të pushtetit gjyqësor për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm

Gjatë viteve të fundit ankesat e qytetarëve të ardhura në adresë të KShH-së për mosrespektimin e të drejtave të tyre nga organet e ndryshme shtetërore kanë qenë të larmishme.

Nëpërmjet klinikës ligjore KShH-ja ka kontribuar në ofrimin e ndihmës ligjore dhe aksesit në drejtësi për kategori të ndryshme personash me fokus individët që u përkasin grupeve të cenueshme.

KShH-ja e vlerëson të nevojshëm vazhdimin e promovimit të ndihmës ligjore dhe të aksesit në drejtësi, nëpërmjet klinikës ligjore, duke i përfaqësuar viktimat në të gjitha nivelet e gjykatave shqiptare si edhe në Gjykatën Europiane të Drejtave të Njeriut. Për të fokusuar më mirë asistencën ligjore te grupet më në

nevojë, KShH-ja do të përcaktojë kritere të qarta të llojit të shërbimeve dhe të profilit të përfituesit të mundshëm nga shërbimet e klinikës ligjore. Vëmendje e posaçme do të vazhdojë të tregohet ndaj grupeve të cenueshme, si: gratë, të miturit, pakicat dhe personat që nuk janë në gjendje të paguajnë një avokat mbrojtës.

KShH-ja do të kontribuojë në:

a) Ofrimin e asistencës ligjore për viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut si rezultat i abuzimit të pushtetit nga autoritetet shtetërore

Do të ofrojë ndihmë ligjore falas nëpërmjet shërbimeve të: këshillimit ligjor të qytetarëve; monitorimit të seancave gjyqësore; asistimit në përpilimin e dokumentacionit të nevojshëm për ankimim dhe përfaqësimin të çështjeve në gjykatat e të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor, përfshi Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Në këtë kuadër, KShH-ja do të bashkëpunojë me shërbime të tjera ligjore brenda dhe jashtë vendit, në funksion të zgjidhjes sa më të mirë të kërkesave të shtetasve shqiptarë.

b) Përmirësimin e rritjes së aksesit të qytetarëve në organet e drejtësisë

Me gjithë përmirësimet e vërejtura në këtë drejtim, vihen re një sërë problemesh, për shkak se reforma gjyqësore në vendin tonë ende nuk ka përfunduar. Për këtë arsye, KShH-ja planifikon të zhvillojë veprimtari për ndjekjen e reformës ligjore në këtë fushë dhe për mirëfunksionimin e pushtetit gjyqësor, si:

- do të ofrojë ekspertizë ligjore në hartimin dhe përmirësimin e legjislacionit;
- do të monitorojë mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë gjyqësore;
- do të ngrejë kapacitetet e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës.

c) Raportimin e gjetjeve

KShH-ja do të hartojë raporte për respektimin e të drejtave të njeriut në sistemin gjyqësor, si dhe do të ofrojë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës.

4.4 Përmirësimi i zbatimit të të drejtave dhe trajtimit të personave të dënuar me heqje lirie

Megjithëse reforma ligjore dhe institucionale në fushën penitenciare ka pasur zhvillime pozitive, mbetet ende shumë punë për të bërë në drejtim të zbatimit sa më të mirë të ligjit dhe menaxhimit human të institucioneve penitenciare shqiptare. Për sa i takon trajtimit të personave të dënuar me heqje lirie në vendet e shoqërimit dhe ndalim/arrestimit, me gjithë masat e marra në këtë fushë, mbetet ende shqetësuese situata në respektimin e të drejtave procedurale dhe trajtimin që u ofrohet individëve në kontakt me Policinë e Shtetit.

Duke pasur parasysh nevojat e përmirësimit të mëtejshëm të situatës në komisariatet e policisë dhe në institucionet penitenciare shqiptare, KShH-ja vlerëson të nevojshëm kontributin në:

a) Ofrimin e ekspertizës për reformën, strategjitë dhe politikat legislative në sistemin penenciar

KShH-ja do të vazhdojë të ndjekë nga afër reformën, strategjitë dhe politikat legislative që do të zhvillohen në fushën e policisë dhe atë penitenciare dhe do të ofrojë oponencën e saj kritike për këto produkte, për të garantuar që ato janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut si dhe për të përmirësuar llogaridhënien dhe zbatimin nga zyrtarët përgjegjës.

b) Monitorimin e situatës në komisariatet e policisë dhe institucionet penitenciare

KShH-ja do vazhdojë të vëzhgojë sistematikisht situatën në komisariatet e policisë dhe burgje edhe gjatë periudhës në vazhdim. Do të ndjekë nga afër zbatimin e sugjerimeve të bëra në vite nga KShH-ja, njësia për parandalimin e torturës (NJPT) pranë Avokatit të Popullit dhe raporteve të organizmave ndërkombëtarë. Do të vazhdojë të bashkëpunojë me organizata të tjera aktive në këtë fushë, me NJPT-në dhe Avokatin e Popullit. Krahas raporteve të vazhdueshme, të publikuara me sugjerimet përkatëse, KShH-ja do të angazhohet në shkrimin e raporteve alternative në këtë fushë.

c) Ndërgjegjësimin dhe informimin e personelit të policisë dhe burgjeve në lidhje me standardet e të drejtave të njeriut dhe funksionimin e shtetit ligjor për institucionet penitenciare

Në mënyrë që të përmirësohet respektimi i të drejtave të personave të dënuar me heqje lirie duhen përmirësuar njohuritë dhe të rritet ndërgjegjësimi i drejtuesve dhe stafit të personelit të Policisë së Shtetit dhe të burgjeve për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut si dhe trajtimin njerëzor të personave nën kujdes të këtyre institucioneve.

KShH-ja do të vazhdojë të ofrojë ekspertizë, trajnime dhe mbështetje në nivele të ndryshme të menaxhimit të Policisë së Shtetit, institucioneve penitenciare, qendrës së trajnimit të burgjeve dhe Drejtorisë së Burgjeve, me qëllim forcimin e menaxhimit dhe të kapaciteteve profesionale të këtyre institucioneve nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut.

d) Kontributin për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të ofruar asistencë ligjore për personat e dënuar me heqje lirie

KShH-ja do të vazhdojë të reagojë në mënyrë aktive ndaj të gjitha ankesave që vijnë nga persona të dënuar me heqje lirie, me fokus të veçantë ndaj grupeve të cënueshme. Do të ofrojë shërbime ligjore falas ndaj të gjithë këtyre personave, do të verifikojë dhe do të ndjekë rastet konkrete të shkeljeve të të drejtave të njeriut nga ana e administratës së autoriteteve shtetërore dhe do të ofrojë përfaqësim ligjor falas në nivele të ndryshme të gjykatave.

Gjithashtu, do të synojë të rritë ndërgjegjësimin dhe ofrimin e asistencës ligjore ndaj personave të dënuar me heqje lirie edhe nëpërmjet botimeve të ndryshme në fushën e të drejtave të njeriut.

4.5 Respektimi i zbatimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi me fokus të veçantë në grupet e cënueshme

Grupet e cënueshme në Shqipëri, si: gratë, të miturit, personat me aftësi të kufizuar fizike dhe mendore, LGBT-të si dhe pakicat rome dhe egjiptiane, shpeshherë ndodhen përballë situatave të diskriminimit nga individë, institucione shtetërore dhe publike etj.

Me hyrjen në fuqi të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi" dhe ngritjen e Zyrës së Komisionerit, qytetarët të cilët përballen me forma të ndryshme të diskriminimit,

kanë hapësirat ligjore për të denoncuar çdo formë diskriminimi dhe për të rivendosur të drejtat e shkelura. Duke pasur parasysh këto zhvillime pozitive, KShH-ja e vlerëson si një nga fushat me përparësi veprimin për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të shkelura të qytetarëve shqiptarë nëpërmjet:

- monitorimit të respektimit të të drejtave të tyre;
- oponencës ligjore ndaj reformave ligjore dhe institucionale të ndërmarra nga qeveria shqiptare;
- ofrimit të ndihmës ligjore falas;
- ndërgjegjësimit qytetar, medias dhe strukturave shtetërore si dhe nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve të strukturave përkatëse.

Me futjen në dekadën e romëve dhe me rritjen e vëmendjes së BE-së për pakicat, kryesisht rome dhe egjiptiane, si dhe në kuadër të përafrimit të legjislationit shqiptar me atë të BE-së, qeveria shqiptare ka ndërmarrë një sërë reformash ligjore për pakicat apo grupet e cenueshme në Shqipëri. Pavarësisht këtyre iniciativave, ende mbeten reforma të rëndësishme ligjore për t'u ndërmarrë në këtë drejtim në përputhje me masat e paraqitura në Planin e veprimit të qeverisë së Shqipërisë për një zbatim të efektshëm të përparësive afatshkurtra të partneritetit europian.

4.6 Aksesit i qytetarit në strukturat publike vendore

Çdo qytetar zotëron të drejta ekonomike, politike dhe sociale, që shpeshherë nuk respektohen siç duhet nga nivele të ndryshme të strukturave vendore. Procesi i decentralizimit në Shqipëri e ngarkoi pushtetin vendor me më shumë përgjegjësi në ofrimin e shërbimeve bazë për shtetasit shqiptarë.

Rritja e aksesit në qeverisjen vendore do të jetë një fushë e re e veprimtarisë së KShH-së në kuadër të strategjisë për vitet 2011-2013.

Më konkretisht, KShH-ja:

- Do të monitorojë në mënyrë aktive respektimin e të drejtave dhe trajtimin e qytetarëve nga strukturat përkatëse shtetërore në nivel vendor.

- Do të raportojë për situatën e vëzhguar dhe do të paraqesë sugjerimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes.
- Do të ofrojë edhe ndihmesë ligjore falas për qytetarët, sidomos për ata që përfshihen në grupet e cënueshme.
- Do të ndërgjegjësojë qytetarët për të drejtat dhe liritë e tyre dhe rrugët e zgjidhjes së problemeve të tyre, si edhe administratën e organeve shtetërore vendore nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të tyre profesionale në këtë fushë.
- Do të bashkëpunojë ngushtësisht edhe me organizata të tjera vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare për sensibilizimin e opinionit publik, medias, strukturave shtetërore dhe ligjvënëse për problematikat e qeverisjes vendore në kuadër të respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut.

5. Zhvillimi institucional i KShH-së

Komiteti Shqiptar i Helsinkit është organizata e parë jofitimprurëse në Shqipëri, por gjithmonë në rritje profesionale. Ai shënoi 20 vjet përpjekje dhe përvojë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në vend. Organizata ka një reputacion mjaft të spikatur, zhvillon veprimtari dinamike dhe manifeston ekspertizë cilësore, të njohur jo vetëm në Shqipëri, por edhe në nivel ndërkombëtar. E ndërgjegjshme se, pavarësisht misionit të vlefshëm dhe qëllimit të mirë, duhet të fuqizohet institucionalisht në mënyrë që të jetë e aftë për t'iu përgjigjur siç duhet nevojave të zhvillimit të shoqërisë, kjo organizatë punon vazhdimisht për fuqizimin e kapaciteteve të veta njerëzore, intelektuale dhe financiare.

Gjatë viteve 2011-2013 KShH-ja do të vazhdojë të përqendrojë përpjekjet edhe në forcimin institucional dhe qëndrueshmërinë e vet organizative.

Fokusi i KShH-së për zhvillimin institucional të organizatës do të jetë:

- Përmirësimi i menaxhimit dhe i kualifikimit të burimeve njerëzore.
- Rritja e qëndrueshmërisë së vet financiare.
- Lobimi dhe fuqizimi i rrjetëzimit.
- Promovimi i mëtejshëm i punës dhe i vlerave të organizatës

5.1 Përmirësimi i menaxhimit dhe kualifikimi i burimeve njerëzore

Pavarësisht përvojës dhe ekspertizës së akumuluar, KShH-ja e vlerëson mjaft rëndësinë e investimit në ngritjen e kapaciteteve të stafit dhe në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të tij. Për këtë arsye do të fokusohet në strategjinë e kualifikimit dhe të zhvillimit të kapaciteteve të stafit të vet në përputhje me nevojat strategjike të organizatës; do të kryejë vlerësime të nevojave reale të stafit për zhvillimin e tyre profesional si dhe do të përzgjedhë alternativa më cilësore për trajnimin dhe zhvillimin e këtyre kapaciteteve.

Njëkohësisht, do të analizojë dhe do të përmirësojë politikat dhe procedurat e menaxhimit të burimeve njerëzore, sa i përket trajnim-zhvillimit, punësimit, shpërndarjes së përgjegjësisë dhe detyrave, si dhe procedurave të largimit nga puna dhe shpërblimit. Procesi i përmirësimit të menaxhimit do të fokusohet edhe në organizimin më të mirë të strukturës organizative të KShH-së, përmirësimin e kushteve materiale të punës dhe fuqizimin e strukturave bazë.

5.2 Përmirësimi i procesit të vëzhgimit

Aktiviteti i KShH-së mbështetet shumë edhe nga rrjeti i korrespondentëve dhe i vëzhguesve të vet në rrethet Kukës, Gjirokastër, Fier, Vlorë, Korçë, Elbasan dhe Shkodër, që jo vetëm siguron ekspertizë dhe informacion për çështje të mprehta në lokalitetet përkatëse, por edhe shërben për të monitoruar respektimin e të drejtave të njeriut nga pushteti lokal. Ky rrjet i jep një ndihmesë mjaft të madhe KShH-së duke dhënë informacion të shpejtë, të verifikuar në vend, për situata të shkeljes së të drejtave të njeriut në rrethe. Nga ecuria e punës së deritanishme KShH-ja e ndien të nevojshme jo vetëm ruajtjen e pranisë së korrespondentëve dhe vëzhguesve në rrethe, por edhe përmirësimin dhe konsolidimin e rolit të tyre në procesin e vëzhgimit dhe të ndjekjes së rasteve të shkeljeve të të drejtave. Pavarësisht kontributit të këtij rrjeti dhe angazhimit të tij mbi baza vullnetarizmi, KShH-ja e ndien se ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm për procesin e vëzhgimit dhe të monitorimit.

Kështu, për të zgjeruar mbulimin gjeografik të vendit me vëzhgues dhe korrespondentë, KShH-ja synon të rritë rrjetin e aktivistëve dhe kapacitetet e tyre në mënyrë që të rritë nivelin e profesionalizmit, objektivitetin në vëzhgim, vetaktivizimin e vëzhguesve, si dhe cilësinë e raportimit të tyre. Gjithashtu, ndien nevojën të rishikojë dhe të përmirësojë edhe procesin e vet të monitorimit të

punës së aktivistëve të saj, të përfshijë rrjetin e aktivistëve në fushatat e KShH-së për lobim dhe mbrojtje ligjore në nivel vendor, si dhe të rritë bashkëpunimin me mediat lokale për të përcjellë mesazhin në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme për publikun e gjerë.

5.3 Rritja e qëndrueshmërisë financiare të organizatës

Për t'u shërbyer sa më mirë interesave të qytetarëve shqiptarë për mbrojtjen e të drejtave të tyre, organizata ka nevojë në radhë të parë të ruajë dhe të forcojë qëndrueshmërinë e saj, sidomos atë financiare. Financimi i KShH-së është realizuar nëpërmjet agjencive donatore të cilat janë të interesuara për fuqizimin e demokracisë në Shqipëri, konsolidimin e shtetit ligjor dhe respektimin e të drejtave të shtetasve shqiptarë.

Zhvillimet në Shqipëri çuan në një rishikim të politikave të financimit nga një pjesë e mirë e donatorëve, aktivë deri vonë në vendin tonë, duke i hapur më shumë rrugë financimit nëpërmjet Delegacionit të Komisionit European në Tiranë, i cili ka qenë një donator i fuqishëm për KShH-në gjatë këtyre viteve të fundit.

Vështirësitë që KShH-ja ka hasur në sigurimin e fondeve janë:

- Krijimi i marrëdhënieve klienteliste nga agjenci donatore që dëmtojnë rëndë funksionimin e shoqërisë civile në Shqipëri.
- Tendenca e donatorëve për të financuar projekte afatshkurtra deri në 1 vit që e vendos organizatën përpara vështirësisë financiare, duke qenë se ajo ndodhet gjithnjë përballë pasigurisë për fonde dhe pamundësisë për të ndërmarrë aksione afatgjata.
- Tendenca për reduktimin e fondeve që mund të përdoren për mbulimin e kostove administrative, nga njëra anë, dhe rritja e këtyre kostove si pasojë e rritjes së çmimeve, nga ana tjetër.
- Sidoqoftë, KShH-ja do të zhvillojë më tej analizën e donatorëve strategjikë për të evidentuar burimet e mundshme të financimit. Do të përmirësojë një sistem funksional për t'iu përgjigjur në kohë thirrjeve të ndryshme për propozime në fushat e veprimtarisë së saj. Do të përdorë të gjitha mundësitë me qëllim përfundimtar të fondeve për organizatën. Në këtë proces për të krijuar akses të organizatës në financim do të kontribuojnë të gjitha strukturat e KShH-së, veçanërisht asambleja dhe bordi këshillimor.

- Komiteti Shqiptar i Helsinkit i kushton kujdes të vazhdueshëm menaxhimit efektiv të kostove operative dhe për projektet, pa cenuar cilësinë, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të fondeve. Sa i përket menaxhimit financiar, KShH-ja ka një epërsi konkurruese, sepse ka një sistem transparent, të qëndrueshëm, që i jep mundësi të marrë të gjithë informacionin e nevojshëm për mirëmenaxhimin e projekteve dhe të programeve të saj. Raportet financiare të KShH-së janë të audituara, prej vitesh tashmë, nga auditues ndërkombëtarë dhe sistemi kontabël që përdor është në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.
- Bazuar në rekomandimet e vazhdueshme të ofruara nga ekspertë të ndryshëm të pavarur, KShH-ja do të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të negociuar me donatorë të ndryshëm me qëllim blerjen e mjediseve të zyrës. Kjo do të çojë në rritje të qëndrueshmërisë së KShH-së dhe, në njëjtën kohë, do të ulë kostot administrative të organizatës gjatë viteve të ardhshme.

5.4 Lobimi dhe fuqizimi i rrjetëzimit

Metodologjia e punës së KShH-së është të ofrojë një cikël të plotë shërbimesh me qëllim rritjen e efektivitetit të punës së vet. Megjithatë, KShH-ja vlerëson rëndësinë e partneritetit dhe bashkëpunimit me organizata të tjera aktive të të drejtave të njeriut për lobim dhe avokati dhe mbrojtje më të mirë të të drejtave të qytetarëve shqiptarë. Ndaj, fuqizimi i partneritetit dhe i rrjetëzimit me organizata dhe aktorë të rëndësishëm vendës dhe të huaj, me qëllim lobimin dhe avokatinë për të drejtat e njeriut në Shqipëri, do të vazhdojë të jetë një nga fushat e strategjisë së KShH-së edhe për tri vitet e ardhshme.

Gjatë këtyre viteve është grumbulluar përvojë në rrjetëzimin e intensifikuar të KShH-së me aktorë aktivë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për çështje të të drejtave të njeriut. Kjo ka sjellë bashkëpunim të frytshëm në një numër rastesh konkrete për presion të efektshëm dhe lobim si dhe në fushatat ndërgjegjësuese.

KShH-ja do të fuqizojë rrjetet e saj me të gjithë aktorët strategjikë, si: organizata të OKB-së, KE-së dhe BE-së, Komitetet e Helsinkit dhe të gjitha organizatat që ndajnë misionin kryesor dhe vlerat me KShH-në.

Gjithashtu, do të stimulojë një përfshirje më të mirë të anëtarëve të bordit dhe të asamblesë së organizatës në komunikimin në media të qëndrimit të KShH-së dhe në rritjen e vizibilitetit të organizatës.

5.5 Promovimi i punës dhe i vlerave të organizatës

KShH-ja vlerëson rëndësinë dhe fuqinë e medias në përcjelljen e mesazhit dhe të informacionit te publiku i gjerë. Kjo organizatë ka qenë aktive në kontaktet e veta me median e shkruar dhe atë vizive për përcjelljen e qëndrimeve dhe të deklaratave të saj për çështje të mprehta që lidhen me misionin e saj, por ka qenë disi modeste në promovimin e punës së saj.

Duke parë zhvillimet e kohëve të fundit, sa i përket kufizimeve të mundësive të financimit, ekzistencës së konkurrencës së pandershme shpeshherë apo klientelizmin e shfaqur në shoqërinë civile, KShH-ja e ndien të nevojshme të jetë më e pranishme në media për të promovuar misionin, punën dhe vlerat në të cilat beson. Për të arritur te publiku, KShH-ja do të përdorë një sërë mjetesh, si: artikuj, konferenca shtypi, intervista me qytetarë të zakonshëm, programe televizive dhe radiofonike për çështje delikate të të drejtave të njeriut etj. Gjithashtu, do të përdorë kontaktet e shumta të saj me gazetarë për të rritur ndjeshmërinë e tyre drejt çështjeve të mprehta të të drejtave të njeriut në vend dhe për t'i nxitur ata të luajnë rol më aktiv në denoncimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Do të rishikojë dhe do të përmirësojë më mirë faqen zyrtare në internet për ta kthyer atë në një portal aktiv të komunikimit më publikun. Në komunikimin më të mirë me publikun, KShH-ja do të vazhdojë të publikojë çdo vit raportin vjetor të organizatës dhe raportin e audituar financiar. Gjithashtu, do t'u dërgojë raporte sipas fushave, donatorëve aktualë dhe atyre potencialë si dhe partnerëve dhe aktorëve kryesorë në fushën e të drejtave të njeriut.